



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër, Zona Qytet".

Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 8(Tete) muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT: 87,345,478 (Tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tete) leke pa tvsh **ose 910,417** (nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) Euro. **Kursi i kembimit 95.94 Lekë/Euro**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 25.03.2026 është 95.94 Lekë/Euro

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë viti 2026 i miratuar me VKB nr.84 datë 18.12.2025”Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2026 - 2028 të Bashkisë së Shkodrës“.

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë **“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”** mbështetur në nenin 42, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe sipas nenit 47 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, i ndryshuar. Arsyeja e përdorimit të kësaj procedure prokurimi është kufiri monetar pasi vlera e fondit limit është mbi kufirin e lartë monetar, të procedurave të prokurimit të sektorit klasik sipas VKM nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik“, Kreu II, pika 1/b.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023-2024-2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **34,938,191** (tridhjetë e katërmilion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të

nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Shkoder dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **34,938,191** (Tridhjetë e katër milion e nentëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e nentëdhjetë e një) Leke që është sa 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike pasi duke parë edhe eksperiencat e mëparshme ata mund të ofertojnë si bashkim operatorësh.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve **2023-2024-2025** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe

kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar të *Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”*, të ndryshuar: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **34,938,191** (Tridhjetë e katër milion e nentëqind e tridhjetë e tete mijë e njëqind e nentëdhjetë e nje) Leke.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”*ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që*

garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvorje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën” dhe nenit 41, pikë 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvorjen e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **34,938,191** (Tridhjetë e katër milion e nentëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e nentëdhjetë e një) Leke përbën nivelin maksimal prej 40% të përvorjes së mëparshme që lejon LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvorja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit , QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.2** është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pikë 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të

përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10 448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është ne perputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohej pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
- b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: *”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”* dhe pika 1, neni 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië dhe të mjedisit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri i mesipër për paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për **Zonën Qendrore**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë
- b) CV përkatëse
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorezojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.4, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV përkatëse të tij.

Kriteri I mësipërm për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për të paktën 3(tre) muajt e fundit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisit ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV
- Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për të paktën 3(tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorezojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 ”Per mbrojtjen e mjedisit” .

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e meparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencen. Është vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vertetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e përditshëm dhe angazhimin e strukture së stafit drejtues.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë fuqi punëtore për realizimin e kontrates prej minimalisht **98 (nëntëdhjetë e tetë) persona** për 3(tre) muajt e fundit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Listëpagesen e sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhura nga punësimi të konfirmuar nga organet tatimore për 3(tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Nëse operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregojnë besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit

ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën **98 (nëntëdhjetë e tetë) persona** është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM per kohen e punes ne muaj per punonjes. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësuar i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Eshte vendosur qe numri i punonjesve ne dispozicion te operatorit ekonomik per realizimin e kontrates te jete minimalisht **98 (nëntëdhjetë e tetë) persona** per 3(tre) muajt e fundit pasi kjo kërkesë lidhet me domodoshmërinë për realizimin e objektit të prokurimit, është në një numër të justifikuar dhe për një periudhë kohore të mëparshme prej 3(tre) muajsh por që i shërben vetëm objektit konkret.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
1	Shofere per grumbullim mbeturina	persona	9
2	Punetor makine per grumbullim mbeturina	persona	27
3	Punetor per fshirje manuale	persona	27
4	Punetor per mirembajtje te rrugeve kryesore, koshave te vegjel, dhe mirembajtjen e PGM've	persona	27
5	Shofer autoboti per larjen e pedonaleve /konteniereve	persona	1
6	Punetor autoboti per larjen e pedonaleve/konteniereve	persona	2
7	Shofer autofshese	persona	1
8	Drejtor teknik per kontraten	persona	1
9	Personi i zyres se kontaktit	Persona	1
10	Monitorues terreni	Persona	2
	Shuma		98

1. Sipermarresi duhet te kete cdo dite ne pune **8 shofere**, per te realizuar **8 rrugetimet** me mjetet teknologjike dhe **1 rrugetim** me kamioncine vetshkarkuese. Sipas normativave te oreve te punes jane perlogaritur edhe **1 shofer** rezerve te cilet do mbulojne ditet e pushimit/festat zyrtare.

2 .Sipermarresi duhet te kete cdo dite ne pune **24 punetore** per grumbullim mbetjesh. Meqenese gjate dites realizohen 8 rrugetime per evadimin e mbatjeve me konteniere, me nga 3 punetore per cikel, nevojiten **24 punetore**. Ndersa per te realizuar mbledhjen e mbetjeve dere-me-dere nevojiten **3 punetore**/dite. Gjithashtu, jane parashikuar dhe perlllogaritur ne kosto edhe punetore reserve te cilet do mbulojne ditet e pushimit/festat zyrtare.

3. Fshirja manuale do realizohet cdo dite ne rreth 160,000 m². Sipas normes se punes 8000 m2/punetor ne dite, eshte e nevojshme te jene cdo dite **20 punetore** ne funksion. Gjithashtu, jane parashikuar dhe perlllogaritur ne kosto edhe 7 punetore reserve te cilet do mbulojne ditet e pushimit/festat zyrtare.

4. Fshirja mekanike realizohet mesatarisht 30 km gjatesi ne dite, ose 45,000 m2, me mjet autofshese. Per te realizuar sherbimin nevojitet vetem **1 shofer**.

5. Mirembajtja e rrugeve, PGM-ve, Koshave te vegjel ne qytet, do realizohet me 2 turne. Per te realizuar mirembajtjen nevojiten cdo dite **10 punetore** ne frekuencen e paradites dhe **10 punetore** ne frekuencen e pasdites (**20 total**). Gjithashtu, jane parashikuar dhe perlllogaritur ne kosto edhe 7 punetore rezerve te cilet do mbulojne ditet e pushimit/festat zyrtare.

6. Larja e pedonaleve me presion dhe solucion eshte parashikuar te realizohet 24 here gjate vitit, mesatarisht 2x/muaj. Siperfaqja totale per 1 cikel larje eshte rreth **26,000 m2**, sipas hartes bashkangjitur ne kete dokument. Per kete proces eshte perlllogaritur nevoja per **1 shofer autoboti** dhe **2 punetore ndihmes**. Keto persona do realizojne gjithashtu edhe larjen e konteniereve sipas grafikut.

7. Stafi administrativ eshte parashikuar **1 Drejtor teknik** per kontraten dhe **1 Personi** i zyres se kontaktit. Per koordinimin dhe monitorimin e punes ne terren duhet te jene **2 monitorues**.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi(emertimi teknik),lloji,marka,nr. i shasisë,viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me poshte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me i vjeter se viti 2008, **4 (katër) copë;**
- b) Makinë teknologjike transportuese (**rezerve**), me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me i vjeter se viti 2008, **1 (një) copë.**
- c) Makinë vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3-5 ton, për mbledhjen e mbetjeve nëpër pedonale derë më derë, viti i prodhimit jo me i vjeter se viti 2008, **1 (një) copë.**
- d) Makine për larjen e rrugëve, (autobot) për larjen e rrugëve me presion, me kapacitet mbajtes 6-8m3, jo më pak se **1 (një) copë;**
- e) Makine autofshese me kapacitet jo me pak se 4-6 m³ **1 (një) copë;**
- f) Makine transporti kontenieresh me kapacitet (3-5) ton **1(nje) copë**

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën **2.3.7**, gërma (a – f) , operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruar në pronësi që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Për mjetet e deklaruar me qera që shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqesë kontratën e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me **tipin e mjetit të porositur(emertimin teknik), llojin, marken, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë**. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Për mjetet e paregjistruara në Republikën e Shqipërisë, paraqitet marrëveshje paraprake e shitblerje **sipas njerit prej rasteve në vijim**,
 - (i) me pronarin e automjeteve.
 - (ii) me koncesionarin ose ndermjetesin në rastin kur ka periudhë tranzitore për të pasur të drejtën e posedimit të mjeteve.
 - (iii) me prodhuesin ose koncesionarin në rastin e paraqitjes në procedurën e prokurimit me mjete të reja.

Në të gjitha rastet subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm i cili verteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit të vendit të origjines, të drejtën për të pasur në pronësi ose gezuar të drejtën e shitblerjes së mjeteve të paraqitura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjeksion më natyror, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimet ligjore në Kodin Civil.

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më i vjetër se viti 2008, **4 (kater) copë**;

Në këto zone në ditë gjenerohen rreth 72 ton mbetje të ngurta urbane. Kjo sasi mbetjesh do të evadohet nga 4 mjete teknologjike 10 ton, të cilët punojnë me 2 turne, pra gjithsej do realizohen 8 rrugetime, 6 rrugetime do realizohen gjatë natës për të evaduar 625 konteniere që ndodhen në territor, dhe 2 rrugetime do realizohen gjatë ditës për të evaduar 205 konteniere (frekuenca e dyte për këto konteniere).

Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. **Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”,** i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

- b. Makinë teknologjike transportuese (**rezerve**), me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më i vjetër se viti 2008.

Ky mjet nevojitet për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

- c. Makinë vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3-5 ton, për mbledhjen e mbetjeve nëpër pedonale derë më derë, viti i prodhimit jo më i vjetër se viti 2008, **1 (një) copë**.

Në këto zone parashikohet të gjenerohen çdo ditë rreth 3.1 ton mbetje të ngurta urbane, për këto arsye është parashikuar të përdoret një mjet kamioncin 3-5 ton. Mjeti do punojë çdo ditë të javës, rreth 6 orë për të realizuar plotësisht frekuencën.

Mjeti vetshkarkues 3-5 ton, është kërkuar për grumbullimin e mbeturinave në zonën e pedonaleve sipas grumbullimit derë më derë. Këto janë zona me destinacion turizmin gjenerimi i mbetjeve shkon mesatarisht 3.1 ton sipas fluksit. **Sipas modelit “Për miratimin**

e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 3-5 ton (85% faktor mbushje) qe do punoje për rreth 6 orë, per te realizuar plotesisht sherbimin.

Mjeti vetshkarkues 3-5 ton, duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. **Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”,** i ndryshuar. sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3. Në llogaritjen e kostove operative (per mjetet) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. (siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking). Kostoja e amortizimit per llogaritje per mjetet e perdorura eshte marre 15 % ne vit.

- d. Makine për larjen e rrugëve, (autobot) për larjen e rrugëve me presion, me kapacitet mbajtes me kapacitet mbajtes $(6-8)m^3$, jo më pak se **1 (një) copë**;

Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion dhe solucion (minimalisht 3ml/1L uje) të ketyre rrugeve e shesheve me makinë teknologjike, si shërbim 24 here ne vit. Sipërfaqja e përgjithshme e cila mund te realizohet per 1 cikël është **26,000 m²** . Larja e rrugëve, duhet te kryhet gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) se tyre.

Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion dhe solucion (minimalisht 3ml/1L uje) të ketyre rrugeve e shesheve me makinë teknologjike, si shërbim 24 here ne vit. Sipërfaqja e përgjithshme e cila mund te realizohet per 1 cikël është **26,000 m²** . Larja e rrugëve, duhet te kryhet gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) se tyre.

- e. Makine autofshese me kapacitet jo me pak se $(4-6) m^3$ **1 (një) copë**;

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet, sipas nje grafiku javor, me një sipërfaqe prej 45,000 m2/dite, ose rreth 30 km vije sherbimi, për 365 ditë të vitit. Këto do të përcaktohen në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Qender

- f. Makine transporti kontenieresh me kapacitet (3-5) ton **1(nje) cope**

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë vendosur sipas modelit “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018 si dhe tek VKB nr. 83, dt. 26.12.2017 “Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Shkodër 2017 - 2022”.